



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201800118/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për ndërhyrjen e menjëhershme dhe hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mirëqënien e fëmijëve të shtetasve SH. I., banorë në Fushë-Krujë.*

Drejtuar: **Kryetarit të Bashkisë Krujë**

K R U J E

Njësisë Administrative Fushë-Krujë

FUSHE-KRUJE

I nderuar Z.Kryetar i Bashkisë,

I nderuar Z.Administrator,

Duke marrë shkas nga publikimi në një media të datës 20.01.2018 me titull "*Fushë Krujë, mjerimi këmbëkryq. Nëna: dy fëmijët të sëmurë. Nëna e dy fëmijëve në mjerim, apel shtetit për ndihmë*". Zyra e Avokatit të Popullit e regjistroi për ta trajtuar si rast me iniciativë.

Konkretisht bëhet fjalë për historinë e dhimbshme të familjes së Zj.Sh. I., nënë 23 vjeçare me dy fëmijë të sëmurë.

Pjesë të artikullit po citojmë: "*Vetëm 25 km larg kryeqytetit, në Fushë Krujë mjerimi është ulur këmbëkryq. Sh.I. jeton në varfëri ekstreme. 23 vjeçarja bashkë me dy fëmijët e saj të vegjël është në mëshirë të fatit. Për vashkëshortin ajo shprehet se nga mjerimi iku në Greqi pa letra, atje e arrestuan dhe ka 9 muaj në burg*". Si të mos mjaftonte varfëria që e ka pllakosur familjen e saj, Sh. Iduhet të zgjidhë problemin e rradhës, për të cilin thotë që është më i rëndë se varfëria. Dy sëmundje që kërkojnë kurim **për Klevisën, vajzën 1 vjeç dhe Klajdin djalin 2 vjeçar**. Vajza ka nevojë për operacion te syri, sepse ka një ind të zmadhuar, djalin e kam me mjekime, është anemik, ka probleme me shëndetin. I bëj thirrje shtetit që të vendosin dorën në zemër për këta fëmijë që po rriten rrugëve, të më ndihmojë me një banesë. Nuk dua asgjë tjetër, përveç që fëmijët e mi **të kenë një shtëpi** që të fusin kokën, **shteti të bëjë diçka për fëmijët të mos rriten rrugëve-shprehet nëna e dy fëmijëve**".

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se "*Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti*". Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë përcakton në nenin 5 se: "*1.Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individët ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e*

anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale”. Detyrimin ligjor për fuqizimin e familjeve në kushtet e vështira social-ekonomike e ka pushteti vendor.

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton në nenin 6/3 se “Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh: a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës.

Vlerësimi i familjes bëhet nga një ekpi multidisiplinar, pjesë e të cilit është dhe përgjegjësi i ndihmës ekonomike por edhe përfaqësues të strukturave të ndryshme, si Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Zyrat e Punës etj., të cilët realisht kryejnë një vlerësim gjithëpërfshirës duke e vënë theksin në interesin më të lartë të fëmijëve. Rasti konkret ka të bëjë me mbijetesën dhe problematikat e një nëne të re, bashkëshorti i së cilës ndodhet në burg në Greqi, dhe ajo vuan varfërinë dhe mungesën e një strehe edhe për dy fëmijëve te saj të mitur (1 dhe 2 vjeç), ndaj ky rast konsiderohet mjaft kompleks dhe **emergjent për ndihmë**.

E konsiderojmë të nevojshme të citojmë disa përcaktime të Ligjit bazë të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës (Ligji 18/2017)

Neni 47

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore i raporton kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe, kur është e nevojshme, në nivel njësie administrative, si dhe koordinon e mbikëqyr punën dhe aktivitetin e tij, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 51

Detyrat e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:

a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;

- b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;
- ç) të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes....”

Ndaj sa më sipër, për realizimin e duhur të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe në zbatim të nenit 21 të **Ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar *“paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të drejtave dhe lirive”*

REKOMANDOJMË:

Vlerësimin e nevojave të fëmijëve të Zj.SH I. dhe hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mbijetesën dhe mirëqënien e fëmijëve të saj.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimi”*, lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve,

Me respekt,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI